



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 57

Tiranë – E mërkurë, 13 prill 2016

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016	Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.....	3593
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 6.4.2016	Për shfuqizimin e vendimit nr. 217, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për Degën e Arkivit Shtetëror Vendor, në Vlorë, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, brenda territorit të pronës nr. 906, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik”, me vendndodhje në Vlorë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, e për një shtesë në vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar”.....	3597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 256, datë 6.4.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	3597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 258, datë 6.4.2016	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Agjencinë e Kërkimit të Teknologjisë dhe Inovacionit.....	3598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 259, datë 6.4.2016	Për kalimin e objekteve “Montim-magazinë-zyra”, “Tranxhat”, “Reparti i stampimit”, “Reparti i elektroauto + WC”, “Reparti mekanik” dhe “Fonderia”, të Ndërmarrjes së Oficinës së Automjeteve, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 650, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e tretë, e katërt dhe e pestë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të qarkut të Tiranës”.....	3598

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 260, datë 6.4.2016	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Kassel” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Objektet nr. 2 (ish-Fabrika e Tubave Rripave), nr. 14/a (ish-Reparti i Kompresorëve), nr. 20 të ish-ndërmarrjes “Goma”, Durrës”, të shoqërisë “NPV” sh.a., Durrës.....	3599
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 6.4.2016	Për revokimin e vendimit nr. 775, datë 4.6.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen “Zonë ekonomike” në Shkodër”.....	3608
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 6.4.2016	Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës.....	3608
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 263, datë 6.4.2016	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.10.2015, për çështjen “Valio Shipping Company kundër Shqipërisë” (aplikimi nr. 34230/07).....	3612
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 264, datë 6.4.2016	Për lëvizjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 65 veprave të artit në poster të artistit hungarez, Peter Pocs, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, të cilat do të ekspozohen në Galerinë Kombëtare të Arteve të Kosovës, Prishtinë, përgjatë muajve prill–maj 2016.....	3612
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 6.4.2016	Për lirin nga detyra të administratorit të shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a.....	3624
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 6.4.2016	Për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes në ngastrat e ekonomive pyjore “Zall-Devoll” dhe “Mollas” të qarkut Elbasan, që do të përdoret nga shoqëria “Delia Group” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Thanë” dhe “Mollas”.....	3624
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 6.4.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 766, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT)”, të ndryshuar.....	3626
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 270, datë 6.4.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Studim, projektim, lidhja e Rrugës Transballkanike me superstradën Fier–Vlorë”.....	3627
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 1876/1, datë 7.4.2016	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Tregu industrial ushqimor-markata”, Berat.....	3630

**VENDIM****Nr. 244, datë 30.3.2016**

**PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE PËR
VENDOSJEN E DETYRIMIT TË
SHËRBIMIT PUBLIK, QË DO TË
ZBATOHEN NDAJ TË LICENCUARVE
NË SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË CILËT USHTROJNË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT,
TRANSMETIMIT, SHPËRNDARJES DHE
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KUSHTET

**PËR VENDOSJEN E DETYRIMIT TË
SHËRBIMIT PUBLIK, QË DO TË
ZBATOHEN NDAJ TË LICENCUARVE NË
SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
CILËT USHTROJNË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT, TRANSMETIMIT,
SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME
ENERGJI ELEKTRIKE**

PJESA I**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen për të licencuarit në

sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.

2. Ky vendim është hartuar në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 2**Objekti**

1. Detyrimi i shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike vendoset duke marrë në konsideratë interesin publik në ushtrimin e këtij aktiviteti, për kushtet që lidhen me:

- a) sigurinë e furnizimit;
- b) cilësinë e shërbimit;
- c) tarifat për kryerjen e një detyrimi të shërbimit publik;
- ç) mbrojtjen e mjedisit;
- d) mbrojtjen e konkurrencës;
- dh) burimet e rinovueshme të energjisë;
- e) eficiencën e energjisë;
- ë) çdo rrethanë tjetër që ndikon në interesin publik;

f) ndryshimet klimaterike.

2. ERE vendos detyrimet specifike të shërbimit publik të një të licencuari në kryerjen e ndonjë prej aktiviteteve të sektorit të energjisë, të përmendura në pikën 1, të nenit 1, të këtij vendimi.

3. Çdo detyrim i shërbimit publik, i vendosur nga ERE, do të përfshihet në termat dhe kushtet e licencës së të licencuarit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregulloren përkatëse të kushteve të licencimit, të miratuar nga ERE.

4. Të licencuarit, licencat e të cilëve përfshijnë detyrimet e shërbimit publik, duhet të marrin të gjitha masat, në mënyrë që të përmbushin detyrimet e shërbimit publik, në përputhje me këtë vendim.

Neni 3**Përkufizime**

1. Çdo term i përdorur në këtë vendim ka të njëjtin kuptim me përkufizimet e termave të dhëna në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. Në këtë vendim, fjalët “...i licencuari përkatës...” nënkuptojnë një të licencuar që kryen aktivitetet e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes ose furnizimit të energjisë elektrike.



Neni 4

Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik

1. Detyrimi i shërbimit publik ndaj një të licencuari vendoset nga ERE, në mënyrë transparente, jodiskriminuese, duke mos penguar hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe të drejtën e furnizuesve të tjerë të energjisë elektrike për të furnizuar klientët në Republikën e Shqipërisë.

2. ERE duhet të argumentojë që vendosja e detyrimit publik është e domosdoshme, jokufizuese, proporcionale dhe e nevojshme.

3. Detyrimi i shërbimit publik për të licencuarin vendoset duke vlerësuar kapacitetin teknik, financiar e organizativ të tij dhe duhet të konsiderojë nëse e njëjta shoqëri po ofron shërbimin publik në të njëjtën zonë apo kategori konsumatorësh, në momentin e vendosjes së këtij detyrimi.

4. Vendimi për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik duhet të:

a) përcaktojë qartë detyrimet, të cilat duhet të kryhen nga i licencuari;

b) përcaktojë qartë të licencuarit e energjisë elektrike, të cilëve u është vendosur detyrimi i shërbimit publik, kur detyrimi i shërbimit publik vendoset mbi një ose më shumë subjekte të licencuar, që ushtrojnë aktivitete në sektorin e energjisë elektrike;

c) specifikojë të drejtat e veçanta të caktuara për të licencuarin, duke arsyetuar se pse ato janë të nevojshme;

ç) përcaktojë kategorinë e klientëve, territorin dhe periudhën për të cilën është vendosur detyrimi i shërbimit publik;

d) shoqërohet me një efekt vlerësimi në lidhje me tregun, cilësinë e furnizimit dhe qëndrueshmërinë;

dh) identifikojë kostot e të licencuarit, ndaj të cilit do të vendoset detyrimi i shërbimit publik;

e) përcaktojë një mekanizëm transparent dhe jodiskriminues për mënyrën se si duhet të mbulohen këto kosto, nëse kostot nuk mbulohen nga tarifa e miratuar.

5. Në rast të vendosjes së detyrimit të shërbimit publik ndaj një të licencuari, të cilit i shkattohen kosto shtesë, që nuk janë përfshirë në tarifën e përcaktuar nga ERE, i licencuari do të kompensohet financiarisht apo në formë të tjera, në

përputhje me pikën 8, të nenit 47, të ligjit nr. 43/2015.

6. I licencuari nuk ka detyrim të shërbimit publik sigurimin e shërbimit të energjisë elektrike në një zonë ku nuk ofrohet shërbimi në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përveç zonave, të cilat janë pjesë e planit rregullator, të miratuar sipas legjislacionit për planifikimin e territorit dhe zhvillimit.

PJESA II

**DISPOZITA TË VEÇANTA PËR
DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK**

Neni 5

Detyrimi i Shërbimit Universal të Furnizimit

1. Shërbimi Universal i Furnizimit është një detyrim i shërbimit publik që i vendoset Furnizuesit të Shërbimit Universal, i cili siguron të drejtën e furnizimit me energji elektrike për një kategori të caktuar të klientëve, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një cilësi të caktuar të furnizimit, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese.

2. Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti. Sasia e energjisë elektrike përcaktohet në kontratën e rregulluar ndërmjet palëve, që miratohet nga ERE, bazuar në një regjim racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historik mesatar vjetor të prodhimit.

3. Në rastet kur Furnizuesi i Shërbimit Universal nuk mund të sigurojë sasinë e nevojshme nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas përcaktimeve të vendosura në pikën 2, të këtij neni, Furnizuesi i Shërbimit Universal ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë në tregun e parregulluar. Furnizuesi i Shërbimit Universal kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, për sasinë e siguruar në tregun e parregulluar, sipas diferencës ndërmjet çmimit të rregulluar të



prodhimit të energjisë elektrike dhe çmimit mesatar të bursës hungareze HUPX, për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse (www.hupx.hu).

4. Sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas përcaktimeve të vendosura në pikën 2, të këtij neni, i shitet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit mesatar të bursës hungareze HUPX, për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin /profilin në bandë, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse dhe përcaktohet, në mënyrë të detajuar, në kontratë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet. Kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE.

5. Brenda datës 1 janar 2018, Këshilli i Ministrave përcakton kushtet për furnizimin e klientëve të energjisë elektrike, të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV, në kuadër të detyrimit të shërbimit publik.

6. Furnizuesi i Shërbimit Universal duhet t'u ofrojë klientëve të drejtën e kontratave standarde, të përgatitura në bazë të kushteve standarde të furnizimit me energji elektrike, të miratuara nga ERE, në përputhje me nenin 84, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe legjislacionit përkatës për mbrojtjen e klientëve.

Neni 6

Çmimi i rregulluar për furnizimin e klientëve nga Furnizuesi i Shërbimit Universal

1. Furnizuesi i Shërbimit Universal është i detyruar të furnizojë klientët e energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të pikave 3, 4 e 5, të nenit 5, të këtij vendimi, me çmime të rregulluara, në të gjithë territorin e Shqipërisë, në përputhje me këtë vendim.

2. Çmimet e rregulluara për shërbimin universal të furnizimit, sipas pikës 1, të këtij neni, miratohen nga ERE, në përputhje me nenin 85, të ligjit nr.

43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe duhet të pasqyrojnë kostot.

3. Pasqyrimi i kostos bëhet duke përfshirë koston e prodhimit, të furnizimit, koston përkatëse të blerjes së energjisë së prodhuar nga burime të rinovueshme, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për burimet e rinovueshme dhe të blerjes së energjisë në tregun e parregulluar, koston për tarifat e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Neni 7

Klientët në nevojë

1. Klientët familjarë, që kanë fituar statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 95, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, kanë të drejtën e përfitimit të shërbimit universal të furnizimit, sipas kushteve të veçanta të furnizimit, të cilat miratohen nga ERE.

2. Çdo kosto shtesë, e bërë nga furnizuesi, në lidhje me kushtet e veçanta të furnizimit për klientët e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, do të mbulohet nga tarifa për shërbimin universal të furnizimit.

Neni 8

Detyrimi për lidhjen në rrjet

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është i detyruar të përmirësojë dhe zgjerojë sistemin e shpërndarjes, me qëllim sigurimin e lidhjes së çdo klienti fundor, i cili nuk është i lidhur në sistemin e shpërndarjes, nën termat, kushtet dhe tarifat e vendosura nga ERE.

2. Pavarësisht detyrimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të ketë detyrimin për të ndërtuar apo zgjeruar sistemin e shpërndarjes në një zonë në të cilën nuk ka ekzistuar rrjet, para vendosjes së këtij detyrimi të shërbimit publik, përveç në zonat, të cilat janë pjesë e një plani territorial, kombëtar ose lokal, të miratuar në përputhje me parashikimet e legjislacionit specifik për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 9

Cilësia e shërbimit

1. Standardet e cilësisë së furnizimit, duke përfshirë kërkesat e nevojshme të vazhdimësisë së



furnizimit në një nivel të qëndrueshëm të tensionit, që duhet të plotësohen nga të licencuarit që kryejnë aktivitetet e gjenerimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit, duke përfshirë ofruesin e shërbimit universal, të përfshira në rregulloret dhe kodet ekzistuese, do të konsiderohen detyrime të shërbimit publik, të vendosura sipas këtij vendimi.

2. Kushtet e cilësisë së furnizimit, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, në lidhje me secilin prej të licencuarve, do të miratohen nga ERE, në përputhje me standardet evropiane të shërbimit të furnizimit.

Neni 10

Siguria e furnizimit

1. Çdo detyrim i vendosur ndaj një të licencuari që kryen aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes ose furnizimit të energjisë elektrike, në përputhje me Rregullat e Sigurisë së Furnizimit, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, do të konsiderohet detyrim i shërbimit publik dhe do të trajtohet sipas dispozitave të këtij vendimi.

2. Çdo investim i bërë nga shoqëria i prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, për kapacitetet e reja gjeneruese, në funksion të plotësimit të kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit, do të trajtohet si një detyrim i shërbimit publik në lidhje me sigurinë e furnizimit. Kostot përkatëse mbulohen nëpërmjet tarifave të miratuara nga ERE.

Neni 11

Burimet e rinovueshme të energjisë

1. Çdo detyrim i vendosur ndaj të licencuarve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në lidhje me burimet e rinovueshme të energjisë, do të konsiderohet detyrim i shërbimit publik.

2. Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE.

Neni 12

Mbrojtja e mjedisit dhe efienca e energjisë

1. Çdo kërkesë, detyrim apo kusht, që vendoset ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, në zbatim të legjislacionit përkatës për mbrojtjen e

mjedisit apo efiençës së energjisë, shqyrtohet nga ERE, për të përcaktuar nëse një kërkesë e tillë, detyrim apo kusht do të zbatohet si detyrim i shërbimit publik.

2. ERE i propozon Këshillit të Ministrave nëse kërkesa, detyrimi apo kushti, sipas përcaktimeve të pikës 1, do të jetë subjekt i dispozitave të këtij vendimi.

PJESA III

DISPOZITA TË TJERA DHE TË FUNDIT

Neni 13

Monitorimi dhe raportimi

1. ERE monitoron zbatimin e detyrimeve të shërbimit publik nga ana e të licencuarve përkatës, sipas këtij vendimi, termave, kushteve dhe licencave përkatëse.

2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe ERE informojnë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për të gjitha masat e vendosura për përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, sipas këtij vendimi, ndikimin e tyre të mundshëm në hapjen e tregut të energjisë dhe nëse këto masa janë në përputhje me Direktivën 2009/72/EC.

3. Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe ERE njoftojnë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë periodikisht, të paktën çdo dy vjet, për çdo ndryshim të kushteve për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14

Dispozita kalimtare

1. Këto rregulla do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, deri në miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. Enti Rregullator i Energjisë, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë aktet përkatëse për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këto kushte.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM****Nr. 255, datë 6.4.2016**

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 217, DATË 23.3.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, PËR DEGËN E ARKIVIT SHTETËROR VENDOR, NË VLORË, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 906, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 7008, FAKULTETI TEORIK”, ME VENDNDODHJE NË VLORË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, E PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121, pika 1, e 124, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 217, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për Degën e Arkivit Shtetëror Vendor, në Vlorë, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, brenda territorit të pronës nr. 906, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik”, me vendndodhje në Vlorë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, e për një shtesë në vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar”.

2. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 256, datë 6.4.2016**

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, shtohet individ i renditur në shkronjën “a” sipas shtesës, bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL DHE AL-QAIDA



a) Lista e ndryshuar në “Listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”;

1. NAYEF SALAM MUHAMMAD UJAM AL-HABABI

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 258, datë 6.4.2016

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR AGJENCINË E KËRKIMIT TË TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2016, në programin “Shërbime për teknologjinë dhe inovacionin”, të grupit buxhetor “Institucione të tjera qeveritare”, zëri “Shpenzime korrente”, të shtohet fondi prej 11 620 000 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë) lekësh, për Agjencinë e Kërkimit të Teknologjisë dhe Inovacionit, i cili të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për mbylljen e veprimtarisë financiare dhe administrative të AKTI-t.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Kërkimit të Teknologjisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 259, datë 6.4.2016

PËR KALIMIN E OBJEKTEVE “MONTIM- MAGAZINË-ZYRA”, “TRANXHAT”, “REPARTI I STAMPIMIT”, “REPARTI I ELEKTROAUTO + WC”, “REPARTI MEKANIK” DHE “FONDERIA”, TË NDËRMARRJES SË OFIÇINËS SË AUTOMJETEVE, TIRANË, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 650, DATË 31.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË INVENTARIT (PJESA E TRETË, E KATËRT DHE E PESTË) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË TIRANË, TË QARKUT TË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 12, 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e objekteve “Montim-magazinë-zyra”, “Tranxhat”, “Reparti i stampimit”, “Reparti i elektroauto + WC”, “Reparti mekanik” dhe “Fonderia”, të Ndërmarrjes së Oficinës së Automjeteve, Tiranë, ndodhur në Rrugën e Kavajës, zona kadastrale 8220, sipas listës bashkëlidhur, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

2. Objektet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 650, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e tretë, e katërt dhe e pestë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”.



3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe kryerëgjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA

E OBJEKTEVE SHTETËRORE TË NDËRMARRJES SË OFIÇINËS SË AUTOMJETEVE TIRANË, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

Nr.	Objekti	Vendndodhja	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sipërfaqja
1.	“Montim-magazinë-zyra”	Tiranë	8220	---	384 m ²
2.	“Tranxhat” dhe “Reparti mekanik”	Tiranë	8220	6/14	869 m ²
3.	“Reparti i elektroauto + WC” dhe “Reparti i stampimit”,	Tiranë	8220	6/142	877 m ²
4.	“Fonderia”	Tiranë	8220	6/143	288 m ²

VENDIM

Nr. 260, datë 6.4.2016

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “KASSEL” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “OBJEKTET NR. 2 (ISH-FABRIKA E TUBAVE RRIPAVE), NR. 14/a (ISH-REPARTI I KOMPRESORËVE), NR. 20 TË ISH-NDËRMARRJES “GOMA”, DURRËS”, TË SHOQËRISË “NPV” SHA, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhenës, dhe shoqërisë “Kassel” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Objektet nr. 2 (ish-Fabrika e Tubave Rripave), nr. 14/a (ish-Reparti i kompresorëve), nr. 20 të ish-Ndërmarrjes “Goma”, Durrës”, në pronësi të shoqërisë “NPV” sh.a., Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme, sipas genplanit, 9888.7 (nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë pikë shtatë) m², nga të cilat sipërfaqe ndërtimore 6683.7 (gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre pikë shtatë) m², si dhe sipërfaqe funksionale 3205 (tre mijë e dyqind e pesë) m², sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



PLAN-RILEVIMI ,GEN-PLANI, PLANIMETRIT E OBJEKTEVE
TE .SHA "NPV",DURRES (PJESA TEK ISH NDERMARJA GOMA,DURRES).
ADRESA : LAGJIA 14,SHKOZET-DURRES.

Autoriteti kontraktor
SHA"NPV"Durres

ADMINISTRATORI
GEZIM ÇULAJ

STUDIO PROJEKTUSE
IRGEN SGT GROUP

ING RIZA XHEMOLLARI



Tirane me :26/10/2015






PER SHA" N.P.V" -DURRES



Administratori

Gezim Çulaj

AUTORITETI KONTRAKTOR: SHA "NPV" Durres		
STUDIO PROJEKTUSE: IRGEN SGT GROUP		
DATA	Përshkrimi i objektit	
Emri i objektit: SHIFRAT E TOTAL E VB. 00000000		
Emri i projektit: PLAN RILEVIMI, GEN-PLANI, PLANIMETRI E OBJEKTEVE		
DATA	SHIFRA	NO. VERTET
06/10/2015	1/00	







**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË**

Nr. _____ Rep.

Nr. _____ Kol.

**KONTRATË QIRAJE
Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata
Lidhur**

Në Tiranë, sot më datë ____ të muajit prill, të vitit 2016 (dy mijë e gjashtëmbëdhjetë), u paraqitën para meje noterit _____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, përfaqësuar me autorizim të MINISTRIT, nr. _____, datë _____.2016, nga z. _____, _____ në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, i datëlindjes _____.19__, banues në _____, me shtetësi shqiptare i pajisur me letër njoftimin Nr. _____, që më poshtë do të quhet “Qiradhënësi”

DHE

Shoqëria “Kassel” sh.p.k., me seli qendrore në Kamzë - Tiranë, dhe me adresë: bulevardi “Blu”, lagjja nr. 4, ndërtesa nr. 660, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKR me NIPT: L21805019F, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. Kastriot Ponari, i biri i Kadriut, i datëlindjes 27.3.1979, lindur në Dushaj – Tropojë dhe banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin personal me nr. 031120596, që më poshtë do të quhet “Qiramarrësi”.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me propozimin të shoqërisë “NPV” sh.a., Durrës mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 6756, datë 3.9.2015 i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, pas konkurrimit të zhvilluar në datën 18.02.2016, në zbatim të urdhrit nr. 8841/6, datë 3.2.2016 të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, shpalli fitues shoqërinë “Kassel” sh.p.k.

Në zbatim të vendimit nr. _____, datë _____.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënësi dhe shoqërisë “Kassel” sh.p.k. si qiramarrës, për pasurinë “Objekti nr. 2 (ish-Fabrika e Tuba Ripave) nr. 14/a (Ish-Reperti i kompresorëve) dhe nr. 20 (ish-Ndërmarrja “Goma”, Durrës), në pronësi të shoqërisë “NPV” sh.a., Durrës dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, së bashku me “Qiramarrësin”, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1**Objekti i kontratës**

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë shtetërore: “Objekti nr. 2 (ish-fabrika e Tuba Ripa) nr. 14/a (Ish-Reperti i kompresorëve) dhe nr. 20 (ish-Ndërmarrja “Goma”, Durrës), në pronësi të shoqërisë “NPV” sh.a., Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme 9888.7 m², nga të cilat sipas genplanit përkatësisht sipërfaqe nën objekt 6683.7 m² dhe sipërfaqe funksionale 3205 m².

Neni 2**Qëllimi i përdorimit**

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për prodhimin e produkteve metalike, të drurit etj.



Neni 3

Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzet) vjet dhe hyn në fuqi me firmosjen e saj nga palët.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 “Qiradhënësi”, nëpërmjet shoqërisë “NPV” sh.a. Durrës, si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet proceverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 “Qiradhënësi” ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e “Qiramarrësit”.

4.3 “Qiradhënësi” është i detyruar të garantojë “Qiramarrësin” për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.4 “Qiradhënësi” ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 60 ditë përpara me shkrim.

4.5 “Qiradhënësi” nuk është i detyruar të garantojë qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 “Qiramarrësi” ka të drejtë që sipas legjislacionit në fuqi të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për të gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 “Qiramarrësi” ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2.

5.3 “Qiramarrësi” detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në planbiznesin e paraqitur në konkurrim.

5.4 “Qiramarrësi”, në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, do të investojë, si punime ndërtimore për rikonstruksion dhe ndërtim të godinës së ambienteve të tjera, blerje dhe vendosje linja e makineri, në vlerën totale prej 674 149 525 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër milionë e njëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekësh, sipas parashikimit për investimet dhe fazat e zhvillimit të tij, të shprehura në planbiznesin e paraqitur në konkurrim, që janë si vijon:

Faza e parë: Me një investim prej 238 749 525 (dyqind e tridhjetë e tetë milionë e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekësh, brenda 6 muajve nga data e marrjes në dorëzim, do të realizohet rikonstruksioni i tri godinave, pas lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij etj.

Faza e dytë: Me një investim prej 435 400 000 (katërqind e tridhjetë e pesë milionë e katërqind mijë) lekësh, brenda 12 muajve nga data e marrjes në dorëzim do të realizohet blerja dhe montimi i makinerive.

Faza e tretë: Është *Start Up* i Fabrikës, 12 muaj nga fillimi i investimeve.

5.5 “Qiramarrësi”, sipas parashikimit për punësimin të shprehur në planbiznesin e paraqitur në konkurrim, detyrohet që, në objektin e marrë me qira, në fund të fazës së parë, 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes në dorëzim të objektit, do të ketë të punësuar 50 (pesëdhjetë) punonjës dhe në fazën e dytë, 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e marrjes në dorëzim të objektit, do të ketë të punësuar edhe 50 (pesë) punonjës të rinj. Në fazën e tretë, 24 (njëzet e katër) muaj pas marrjes në dorëzim të pasurisë do të punësohen 150 (njëqind e pesëdhjetë) punonjës të rinj. Pra, në përfundim të 24 (njëzet e katër)



muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit, “Qiramarrësi” do të ketë të punësuar 250 (dyqind e pesëdhjetë) punonjës.

5.6 “Qiramarrësi” detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira sipas kësaj kontrate, të paraqesë para qiradhënësit shtesën e planbiznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.4 dhe 5.5 të kësaj kontrate.

5.7 “Qiramarrësi” detyrohet të paraqesë tek “Qiradhënësi” në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.8 “Qiramarrësi” detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.9 “Qiramarrësi”, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. “Qiradhënësi” nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga “Qiramarrësi”.

5.11 Në ngarkim të “Qiramarrësit” janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

Neni 6

Pagesa e qirasë

6.1 “Qiramarrësi” detyrohet t’i paguajë “Qiradhënësit” detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro. Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës “Qiramarrësi” ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën 13 482 991 (trembëdhjetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një) lekë, sipas faturës së lëshuar nga “Qiradhënësi”, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.4 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penaltete (gjyba dhe kamatëvonesa), “Qiramarrësi” do të likuadojë vlerat e krijuara në llogarinë e “Qiradhënësit” sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7

Penalitetet

7.1 Në rastin kur “Qiramarrësi”, në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar investimet e përcaktuara në pikën 5.4, të kësaj kontrate, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse pas 6 muajve investimi vazhdon të mosrealizohet, “Qiradhënësi” zgjidh kontratën dhe gjobit “Qiramarrësin” me vlerën e garancisë së ngurtësuar në atë moment.

7.2 Në rastin kur, “Qiramarrësi”, në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.5 të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për çdo vend pune të pahapur.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

- a) në marrëveshje midis palëve;
- b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;
- c) kur “Qiramarrësi” shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 5 dhe 6 të kësaj kontrate.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 60 ditë pas njoftimit me shkrim të “Qiradhënësit” për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse “Qiramarrësi” nuk ka reaguar me shkrim.



Neni 9

Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të çdo faze për investimin, pas relacionit të paraqitur nga “Qiramarrësi”, sipas pikave 5.4, 5.5 dhe 5.6 të kësaj kontrate, palët janë të detyruara të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, shoqërisë “NPV” sh.a. Durrës dhe “Qiramarrësit”, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël.

9.3 Palët, “Qiramarrësi” dhe shoqëria “NPV” sh.a., Durrës janë të detyruara që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me “forcë madhore” do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste, palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 “Qiramarrësi” përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe moskryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10

Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t’u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë planbiznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe proces verbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t’i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes
përfaqësuar nga
Alban Beqaj

QIRAMARRËSI

Shoqëria “Kassel” sh.p.k.
përfaqësuar nga
Kastriot Ponari

**VENDIM****Nr. 261, datë 6.4.2016****PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 775,
DATË 4.6.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN “ZONË
EKONOMIKE” NË SHKODËR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 2, të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, dhe të neneve 121, 122 dhe 125, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Revokimin e vendimit nr. 775, datë 4.6.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen “Zonë ekonomike”, në Shkodër”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 262, datë 6.4.2016****PËR SHPALLJEN E ZONËS SË
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK NË SPITALLË, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” të territorit, me sipërfaqe 199.7 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë pikë shtatë) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, në Spitallë, Durrës, në përbërje të së cilës janë parcelat me numra pasurie, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në këtë zonë janë:

- a) prodhuese, industriale dhe agropërpunim;
- b) tregtare dhe magazinim mallrash;
- c) shërbime.

4. Periudha e funksionimit të zonës është deri në 99 vjet.

5. Dhënia e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik me qira të bëhet me çmimin simbolik 1 euro.

6. Përzgjedhja e zhvilluesit të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese.

7. Si fazë e parë, të përzgjidhet zhvilluesi për një sipërfaqe prej 101.2 (njëqind e një pikë dy) ha, sipas hartës dhe numrave të pasurive bashkëlidhur.

8. Kriteret, në bazë të së cilave vlerësohen zhvilluesit, të jenë:

- a) propozimi i projektit teknik;
- b) ndikimi mjedisor;
- c) ndikimi social;
- d) kohëzgjatja e punimeve;
- e) kapaciteti financiar i kompanisë dhe mundësia e financimit të projektit.

9. Vendimi nr. 666, datë 29.7.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e e zonës teknologjike të zhvillimit ekonomik, në Spitallë, Durrës”, i ndryshuar, shfuqizohet.

10. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK” SPITALLË, DURRËS

<i>Nr.</i>	<i>Zona kadastrale</i>	<i>Nr. Pasurie</i>	<i>Lloji i pasurisë</i>	<i>Sipërfaqja m²</i>
1	8,517	36	ARE	72,605
2	8,517	37	ARE	72,955
3	8,517	45	ARE	142,500
4	8,517	46	ARE	142,500
5	8,517	47	ARE	141,000
6	8,517	48	ARE	140,250
7	8,517	49	ARE	146,375
8	8,517	50	ARE	135,000
9	8,517	63	ARE	142,200
10	8,517	64	ARE	155,235
11	8,517	65	ARE	147,730
12	8,517	66	ARE	148,520
13	8,517	78	ARE	102,648
14	8,517	79	ARE	102,102
15	8,517	80	ARE	107,016
16	8,517	81	ARE	98,280
				1,996,916



SPITALLA

1:20 000

Sipërfaqja - 199.7 ha

- Rruga Kryesore
- Superstradë
- Rrugë dytësore
- Kufijtë e zonës
- Det
- Portat e zonës

LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK” SPITALLË, DURRËS, FAZA E PARË

Nr.	Zona kadastrale	Nr. Pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²
1	8,517	36	ARË	72,605
2	8,517	37	ARË	72,955
6	8,517	48	ARË	140,250
7	8,517	49	ARË	146,375
8	8,517	50	ARË	135,000
9	8,517	63	ARË	142,200
10	8,517	64	ARË	155,235
11	8,517	65	ARË	147,730
				1,012,350



SPITALLA
1:20 000
Sipërfaqja – Faza e parë sip.101.2

— Rruga Kryesore
— Superstradë
— Rrugë dytësore
--- Kufijtë e zonës
Det
○ Portat e zonës

**VENDIM****Nr. 263, datë 6.4.2016****PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 6.10.2015,
PËR ÇËSHTJEN “VALIO SHIPPING
COMPANY KUNDËR SHQIPËRISË”
(APLIKIMI NR. 34230/07)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.10.2015, për çështjen “Valio Shipping Company kundër Shqipërisë” (aplikimi nr. 34230/07), në favor të shoqërisë “Valio Shipping Company”, në shumën 1 288 455 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë) USD, për sa i përket dëmit pasuror.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku do të depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim, nga ekzekutimi i këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesit, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.10.2015, për çështjen “Valio Shipping Company kundër Shqipërisë” (aplikimi nr. 34230/07).

4. Pagesa e shumës së depozituar në favor të “Valio Shipping Company”, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda një afati 3-mujor nga data që vendimi është bërë përfundimtar, data 6.10.2015.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 3, të këtij vendimi, të shumës

së përcaktuar si detyrim, të paguhet interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, për periudhën e mospagimit, plus tre për qind.

6. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi****VENDIM****Nr. 264, datë 6.4.2016****PËR LËVIZJEN JASHTË TERRITORIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË 65
VEPRAVE TË ARTIT NË POSTER TË
ARTISTIT HUNGAREZ, PETER POCS,
PJESË E FONDIT TË GALERISË
KOMBËTARE TË ARTEVE, TË CILAT DO
TË EKSPOZOHEN NË GALERINË
KOMBËTARE TË ARTEVE TË KOSOVËS,
PRISHTINË, PËRGJATË MUAJVE
PRILL–MAJ 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 65 (gjashtëdhjetë e pesë) veprave artistike, objekte të rralla, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim ekspozimin në ekspozitën personale të artistit Peter Pocs “3P”, që do të çelet pranë Galerisë Kombëtare të Kosovës, në Prishtinë, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lejimi i lëvizjes të bëhet nga data 4 prill deri më 25 maj 2016.

3. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr.2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të

luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

4. Ngarkohen Galeria Kombëtare e Arteve të kryejë shoqërimin dhe kthimin e veprave në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë, dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.




5. Ngarkohet ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lista 1




LISTA E PUNËVE TË ARTISTIT PETER POCS PER EKSPOZITËN “3P” 8.4.2016–8.5.2016 GALERIA E ARTEVE E KOSOVËS

Nr.	Imazhi	Titulli/Teknika/Të dhëna	Viti	Përmasa	Çmimi lekë
1		<i>Plakatet e Péter Pócs 1977 - 1987</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Katalin Néray Pallati Ekspozitave, Budapest, Foto: Péter Walter	1987	100 x 69 x 0.5 cm Edicioni: 350 kopje	28,000
2		<i>Jozsef Kantona: Ban Bak</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Ferenc Lendvay Teatri Jozsef Kantona, Kecskemet, Hungari Foto: Laszlo Haris	1987	98 x 68.5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	21,000
3		<i>Dostoievski: Banori i Zgavrave</i> Teknika: offset në KAPA®fix Porositësi: Sándor Pinczehelyi Galeria e Qytetit Pécs, Pécs, H. Foto: József Ballai	1987	98,5 x 67,5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	21,000
4		<i>PERPARA!</i> (Ekspozita e Sándor Pinczehelyi) Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Sándor Pinczehelyi Galeria e Qytetit Pécs, Pécs, H. Foto: József Ballai	1986	68 x 97,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	28,000





5		<i>Plakatet e Shigeo Fukuda</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Sándor Pinczehelyi Galeria e Qytetit Pécs, Pécs, H. Foto: József Ballai	1987	98,5 x 67,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	21,000
6		<i>Ekspozitë nga Koleksioni i Muzeut Hungarez të Artistëve Naivë</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Sándor Pinczehelyi Galeria e Qytetit Pécs, Pécs, Hungari. Foto: Jozsef Ballai	1987	98,5 x 67,5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
7		<i>Plakatet e Péter Pócs</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Szilárd Solecki, Galeria e Vogël Komárom, Komárom, Hungari Foto: László Haris	1988	99,5 x 68,5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
8		<i>Festivali Pranveror Kecskemét</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: László Katona, Bashkia e Qytetit, Kecskemét, Hungari. Foto: Peter Walter	1996	110 x 80,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	21,000
9		<i>Festivali Boteror i Kukullave UNIMA</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, POSTER'V. Design Studio, Kecskemét, Foto: Péter Walter	1996	110 x 80,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	21,000
10		<i>Lajos Parti Nagy: Ibusár</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: László Bagossy, Teatri József Katona, Kecskemét, Foto: Peter Walter	1997	67,5 x 98,5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	21,000




11		<i>LÚDICA - 13 (Arti dhe Kultura e Dizajnit ne Meksike)</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Xavier Bermúdez, Revista Lúdica, Meksikë Foto: Péter Walter	2002	112 x 85,5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
12		<i>TNAGYTAMÁS (Tamás T. Nagy - trege tar)</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Tamás T. Nagy, Tamás T. Nagy Ltd., Budapest, Foto: Péter Walter	2007	121 x 87 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	14,000
13		<i>Tatuazh në Hungari</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Sándor Pinczehelyi Galeria e Qytetit Pécs, Pécs, H. Foto: József Ballai	1987	99 x 68 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
14		<i>Boris Pasternak: Doktor Zhivago</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Sándor Pinczehelyi Galeria e Qytetit Pécs, Pécs, H. Foto: József Ballai	1988	100 x 69 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
15		<i>Kolodi – Bohm: Pinoku</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Sándor Pinczehelyi Galeria e Qytetit Pécs, Pécs, H. Foto: József Ballai	1987	67,5 x 98 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
16		<i>Jozsef Attila: Vepra e Plotë</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Sándor Pinczehelyi Galeria e Qytetit Pécs, Pécs, H. Foto: József Ballai	1988	87 x 121 x 0.5 cm Edicioni: 3 x 500 kopje	28,000
17		<i>Transilvania</i> Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Sándor Pinczehelyi Galeria e Qytetit Pécs, Pécs, H. Foto: József Ballai	1988	87 x 121 x 0.5 cm Edicioni: 1500 kopje	35,000



18		25 Vjet Kolonia Nderkombetare e Artisteve ne Hajdusag Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Katalin Néray, Pallati Ekspozitive, Budapest, Foto: László Haris	1989	68 x 98,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	14,000
19		GITANES <i>(Hommage à Max Ponti)</i> Teknika: serigrafi Porositësi: Alain Weill, Flammarion, Paris, Francë Foto: László Haris	1991	67 x 98,5 x 0.5 cm Edicioni: 300 kopje	21,000
20		SIMILE (Ekspozita e Péter Stefanovits) Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Stefanovits, NOVOTOYS, Budapest, HUN. Foto: László Haris	1988	98,5 x 68 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	35,000
21		Ekspozita e Parë e Péter Pócs në Francë Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Claude Hernandez, City Council, Castelmoron d'Albret, Francë Foto: László Haris	1988	98,5 x 68 x 0.5 cm Edicioni: 350 kopje	28,000
22		Gyula Háy: Kali Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, Kecskemét, Hungari Foto: László Haris	1988	99,5 x 68,5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	21,000
23		23.10.'56 / 1989 Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, Kecskemét, Hungari Foto: László Haris	1989	98,5 x 67,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	42,000






24		301 Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Bálint Magyar, SZDSZ (Bashkimi i demokratëve të lirë), Budapest, Hungari Foto: László Haris	1989	98,5 x 67,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	35,000
25		Hommage à Romania Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, Kecskemét, Hungari Foto: László Haris	1989	99 x 68 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	28,000
26		Purga Teatro Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Géza Kovács, Teatri Kukullaye Ciroka, Kecskemét, Hungari, Foto: Peter Walter	1991	98 x 68 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
27		1989 - ? Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, Kecskemét, Hungari	1989	68 x 98 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	21,000
28		Péter Pócs në Lozanë Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Christoph Herman, University, Lausanne, Zvicër Foto: Péter Walter	1992	98,5 x 68 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	21,000
29		1990 – 1994 Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, POSTER'V. Design Studio, Kecskemét, Hungari Foto: Péter Walter	1994	100 x 70 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	21,000







30		DOPP në GGG (Galeria Grafike Ginza) Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, POSTER'V. Design Studio, Kecskemét, Hungari Foto: Péter Walter	1996	110 x 80,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	28,000
31		Skulpturat e Zoltán Pál Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, POSTER'V. Design Studio, Kecskemét, Hungari Foto: Péter Walter	1993	69,5 x 99,5 x 0.5 cm Edicioni: 450 kopje	21,000
32		Skulpturat e Zoltán Pál Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, POSTER'V. Design Studio, Kecskemét, Hungari Foto: Péter Walter	1993	69,5 x 99,5 x 0.5 cm Edicioni: 450 kopje	21,000
33		100 Vjet te Teatrit József Katona në Kecskemét Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: József Bal, Teatri József Katona, Kecskemét, Hungari, Foto: Péter Walter	1996	80,5 x 110 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	28,000
34		TEATRI NGA TEATRI (Reklame për abonim sezonal) Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Géza Bodolay, Teatri József Katona, Kecskemét, Hungari Foto: Péter Walter	1998	83,5 x 112 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
35		Tamás T. Nagy - Kompani e Tregtimit te Djathit Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Tamás T. Nagy, Tamás T. Nagy Ltd., Budapest, Foto: Péter Walter	2000	85 x 111,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	42,000





36		ENQUA (Enviroment & Quality Service Ltd.) Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Heine Sveistrup Jensen, Enqua Ltd., Aarhus, Foto: Péter Walter	2003	84,5 x 111,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	35,000
37		Tamás T. Nagy – Kompani e Tregtimit te Djathit Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Tamás T. Nagy, Tamás T. Nagy Ltd., Budapest, Foto: Péter Walter	2003	84,5 x 111,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	35,000
38		Festivali i 1 Nde rkombe tar i Filmit te Animuar dhe me Kartona Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Ferenc Mikulás, Kecskemétfilm, Hungari Foto: Péter Walter	1996	110 x 81 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	28,000
39		Tamás T. Nagy – Kompani e Tregtimit te Djathit Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Tamás T. Nagy, Tamás T. Nagy Ltd., Budapest, Foto: Péter Walter	2000	111,5 x 85 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	35,000
40		Tamás T. Nagy – Kompani e Tregtimit te Djathit Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Tamás T. Nagy, Tamás T. Nagy Ltd., Budapest, Foto: Péter Walter	2000	111,5 x 85 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	35,000





41		Leksiku i Artit Bashke □ kohor Hungarez Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Éva F. Almási, Botuesi Encyclopedia, Budapest, Hungari Foto: Peter Walter	2000	100,5 x 69 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	28,000
42		Reinold Queneau: Praktike □ Stili Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Gyula Radó, Teatri Komédium, Budapest, Hungari Foto: Péter Walter	2001	110 x 83,5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
43		AFISHE TEATRORE (Ekspozita e Péter Pócs) Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, POSTER'V. Design Studio, Budapest, Hungari Foto: Péter Walter	2001	110 x 84 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
44		TOULOUSE-PÓCS (Homazh Toulouse-Lautrec) Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Anton Beeke, Toulouse- Lautrec Museum, Albi, France Foto: Péter Walter	2001	98 x 68 x 0.5 cm Edicioni: 300 kopje	28,000
45		Tamás T. Nagy – Kompani e Tregtimit te □ Djathit Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Tamás T. Nagy, Tamás T. Nagy Ltd., Budapest, Foto: Péter Walter	2002	111,5 x 84,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	35,000
46		Instituti i Kulture □ s Daneze Mbush 10 Vjet ne □ Hungary Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix, Porositësi: Thomas Berntsen, Instituti Kulturës Daneze Kecskemét, Hungari Foto: Péter Walter	2002	111,5 x 84,5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000



47		LE NOUVEAU SALON DES CENT (Hommage à Toulouse-Lautrec) Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: John Warren Gotsch, Ateliers Pro Arts, Budapest, Hungari Foto: Péter Walter	2002	112 x 85,5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
48		Péter Pócs / Fytyra Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, POSTER'V. Design Studio, Budapest, Hungari Foto: Péter Walter	2002	111,5 x 84,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	21,000
49		Péter Pócs: Plakate! Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Erik Bach Andersen, Viborg County, Viborg, Danimarkë. Foto: Peter Walter	2003	111,5 x 84,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	28,000
50		MIRËMËNGJES, MEKSIKO! (Ekspozite e Péter Pócs) Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, POSTER'V. Design Studio, Budapest, Hungari Foto: Péter Walter	2003	111,5 x 84,5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	35,000
51		Plakatet e Péter Pócs në Castelmoron d'Albret Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Claude Hernandez, Holli i Qytetit, Castelmoron d'Albret, Francë Foto: Péter Walter	2003	111,5 x 84,5 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	35,000




52		Tamás T. Nagy – Kompani e Tregimit te Djathit Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Tamás T. Nagy, Tamás T. Nagy Ltd., Budapest, Foto: Péter Walter	2004	121 x 87 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	35,000
53		23.10.'56 / 1956 – 2006 Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Heine Svestrup Jensen, Enqua Ltd., Aarhus, Danimarkë Foto: Péter Walter	2006	121 x 87 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	42,000
54		23.10.'56 / 1956 – 2006 Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Heine Svestrup Jensen, Enqua Ltd., Aarhus, Danimarke Foto: Péter Walter	2006	121 x 87 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	35,000
55		Postermania Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, Hungarian Poster-loneliness Association, Budapest, Hungari Foto: Péter Walter	2006	121 x 87 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	42,000
56		Pllakatë nga Hungaria Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Peder Stougaard, Muzeu Danez i pllakatit, Aarhus, Foto: Péter Walter	2001	110,5 x 83,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	35,000
57		LUDVIG (Kolonja Nderkomebare e Artisteve) Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Zoltán Ludvig, Nagykanizsa – Kendlimajor, Hungary Foto: Péter Walter	2003	84,5 x 111,5 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	28,000



58		50 Pllakate nga Péter Pócs, Hungari Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, POSTER'V. Design Studio, Budapest, Hungari Foto: Péter Walter	2004	85 x 120,5 x 0.5 cm Edicioni: 350 kopje	28,000
59		Karma Hungareze Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Bent Hansen, Presidenti i rajonit East-Jutland, Danimarkë Foto: Péter Walter	2009	87 x 121 x 0.5 cm Edicioni: 350 kopje	28,000
60		UNITED COLORS OF HUNG(A)RY - 1990 - 2090 (Bla...Bla...Bla...) Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, Hungarian Poster Association, Budapest, Hungari Foto: Péter Walter	2000 - 2005	70 x 100 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	28,000
61		Postermania Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, Hungarian Poster-loneliness Association, Budapest, Hungari Foto: Péter Walter	2006	121 x 87 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	35,000
62		Attila József 1905 - 1937 - 2005 Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, Hungarian Poster Association, Budapest, Hungari Foto: Péter Walter	2005	70 x 100 x 0.5 cm Edicioni: 400 kopje	35,000
63		Kushtetute, por jo një si kjo! Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Balint Magyar, SZDSZ (Bashkimi Demokratike të Lire), Budapest, Hungari Foto: László Haris	1989	68 x 97,5 x 0.5 cm Edicioni: 1500 kopje	35,000



64		Nëse jeni të lodhur me bananen dhe portokallin (politikane), zgjidhni pllakatin! Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Péter Pócs, POSTER'V. Design Studio, Kecskemét, Hungari Foto: Péter Walter	1994	117,5 x 84 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	21,000
65		Festivali i 2 i filmit të animuar dhe me kartona, Kecskemét Teknika: print offset ngjitur në KAPA®fix Porositësi: Ferenc Mikulás, Pannónia Film Studio, Kecskemét, Hungari Foto: László Haris	1988	99,5 x 69 x 0.5 cm Edicioni: 500 kopje	42,000
				Totali	1,869,000 ose €13,500

Imazhet për posterat dhe të dhënat nga:

Peter Pocs

Kontrolloi:

Genti Gjickola

VENDIM

Nr. 265, datë 6.4.2016

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË “NXITJA E BIZNESIT SOCIAL” SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 20, të statutit të shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a., miratuar me vendimin nr. 391, datë 1.6.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a.”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lirimin nga detyra të znj. Ardita (Jola) Bonatti, administrator i shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËRVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 267, datë 6.4.2016

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E EKONOMIVE PYJORE “ZALL-DEVOLL” DHE “MOLLAS” TË QARKUT ELBASAN, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “DELIA GROUP” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “THANË” DHE “MOLLAS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 90 ha, në ngastrat 1b, 3, 4a, 4b, 5a, 5b, 6, 7c 8b, 9c, 10c, të ekonomisë pyjore “Zall-Devoll”, dhe në ngastrat 2, 3, 4, të ekonomisë pyjore “Mollas”, të qarkut Elbasan, që do të përdoret nga shoqëria “Delia Group” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Thanë” dhe “Mollas”, të hiqet nga fondi pyjor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Subjekti “Delia Group” sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë një sipërfaqe të barabartë me atë të marrë në përdorim. Vlera e sipërfaqes së hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga subjekti “Delia Group” sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Delia Group” sh.p.k., të pyllëzojë me fondet e veta, brenda 5 (pesë) viteve, sipërfaqen 90 ha, fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara nga Ministria e Mjedisit në marrëveshjen e lidhur me subjektin “Delia Group” sh.p.k.

4. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes nga shoqëria “Delia Group” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet “fond pyjor”, sipas mënyrës së rehabilitimit.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

Tabela 1 - Sipërfaqet që do të hiqen nga fondi pyjor sipas përdorimit të territorit dhe pronësisë

Nr	Emërtimi i ekonomisë	Ngastra	Sip. që do hiqet (ha)	Përdorimi territorit	Qeverisja	Funksioni kryesor	Pronësia
1	Zall-Devoll	1b	4.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
2	Zall-Devoll	3	6.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
3	Zall-Devoll	4a	8.2	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
4	Zall-Devoll	4b	2.8	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
5	Zall-Devoll	5a	6.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
6	Zall-Devoll	5b	9.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
7	Zall-Devoll	6	8.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
8	Zall-Devoll	7c	5.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
9	Zall-Devoll	8b	7.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
10	Zall-Devoll	9c	2.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
11	Zall-Devoll	10c	1.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
12	Mollas	2	8.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
13	Mollas	3	7.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
14	Mollas	4	10.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
TOTALI			90				

**VENDIM**

Nr. 269, datë 6.4.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 766, DATË 14.9.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE
PËR SIGURINË KOMPJUTERIKE
(ALCIRT)", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 766, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronjat "d" dhe "e" ndryshohen, si më poshtë vijon:

"d) Nxjerr rregullat e sigurisë së rrjeteve dhe të sistemeve kompjuterike shtetërore;

...



e) Propozon plotësimin e legjislacionit në fushën e sigurisë kompjuterike dhe merr pjesë në përgatitjen e bazës ligjore për çështjet, që lidhen me fushën e kimit kibernetik;”.

b) Në fund të shkronjës “P” shtohen fjalët “...veçanërisht për çështjet që ndikojnë në sigurinë e fëmijëve që përdorin internetin.”.

c) Pas shkronjës “g” shtohen shkronjat “gj”, “h” dhe “i”, me këtë përmbajtje:

“gj) Realizon kontrollin periodik të zbatimit të rregullave të sigurisë kompjuterike, të nxjerra sipas shkronjës “d” të kësaj pike, të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha institucionet shtetërore, duke përfshirë ato institucione, sistemet kompjuterike të cilave u nënshtrohen rregullimeve të veçanta ligjore:

i) Për institucionet që varen nga Kryeministri apo Këshilli i Ministrave, detyrat e kontrollit dhe verifikimit kryhen sipas një grafiku dhe plani pune, të miratuar nga Kryeministri.

ii) Agjencia regjistron në një regjistrë të veçantë çdo procedurë kontrolli a verifikimi.

h) Mban raportet e ngjarjeve të sigurisë kompjuterike që konstatohen në rrjetet/sistemet kompjuterike shtetërore;

i) Krijon dhe përditëson regjistrin kombëtar të ngjarjeve kompjuterike dhe regjistrin e pikave të kontaktit kombëtare/ndërkombëtare;”.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, me këtë përmbajtje:

“3.1 Çdo institucion shtetëror dhe publik detyrohet të caktojë pikat e kontaktit për çështjet e sigurisë kompjuterike dhe të raportojë menjëherë pranë ALCIRT-it për çdo ngjarje që cenon sigurinë në rrjetet/sistemet e tyre kompjuterike.

3.2 Rregullat e sigurisë të nxjerra nga ALCIRT-i, sipas shkronjës “d”, të pikës 3, të këtij vendimi, publikohen në Buletin e Njoftimeve Publike.

3.3 Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) propozon marrjen e masave disiplinore ndaj çdo nëpunësi përgjegjës, i cili me veprimet ose mosveprimet e tij nuk zbaton rregullat e nxjerra sipas shkronjës “d”, të pikës 3, të këtij vendimi.”.

3. Pika 7 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 270, datë 6.4.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “STUDIM, PROJEKTIM, LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME SUPERSTRADËN FIER-VLORË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Studim, projektim, lidhja e Rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme 11 356 803 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tre) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 11 356 803 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tre) lekësh, të përballohet nga llogaria e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.



8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së

gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



Nr.	Zona kadastrale	Nr.	Pronari	Sipërfaqe trualli	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit	Çmimi i ndërtimit	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit dhe truallit lekë	Vlera ndërtimit	Shënime
1	8605	33/385-ND	Fatmir Driza	0	71.89	8300	51,831	-	3,726,130.59	3,129,443.59	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	8605	33/391-ND	Ismete Braka (1/7)	0	41	8,300	51,831	-	303,581.57	254,967.29	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
			Elca Xhelaj (1/7)						303,581.57	254,967.29	
			Edlira Kolndreu (1/7)						303,581.57	254,967.29	
			Rabushe Sinanaj (1/7)						303,581.57	254,967.29	
			Alban Braka (1/7)						303,581.57	254,967.29	
			Rudina Kamberaj (1/7)						303,581.57	254,967.29	
			Rozeta Bejtaj (1/7)			8,300		-	303,581.57	254,967.29	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	8605	33/411-ND	Gezim Begaj	0	50	8,300	51,831	-	2,591,550	2,176,550	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	8605	33/331-ND	Artur Ilia (5/6)		53	8,300	51,831	-	2,289,202.50	1,922,619.17	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
			Ferdinant Ilia (1/6)						457,840.50	384,523.83	
5	8605	2/208-ND	Bukuroshe Gjolekaj (1/7)	0	45	8,300	51,831	-	333,199.29	279,842.14	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
			Arben Gjolekaj (1/7)						333,199.29	279,842.14	
			Renato Fjolekaj (1/7)						333,199.29	279,842.14	
			Valbona Çobo (1/7)						333,199.29	279,842.14	
			Irena Gjolekaj (1/7)						333,199.29	279,842.14	
			Alban Gjolekaj (1/7)						333,199.29	279,842.14	
			Spartak Gjolekaj (1/7)						333,199.29	279,842.14	

Shuma	11,356,802.59
--------------	----------------------

**KËRKESË****Nr. 1876/1, datë 7.4.2016****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Tregu industrial ushqimor-markata”, Berat.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që

shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” të ndryshuar. Për pronarët, sipas listës emërore bashkë-lidhur.

Pronarët, për të cilët është bërë shënimi “Saktësim dokumentacioni”, do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim,

Vlera gjithsej e shpronësimit për 5 (pesë) pronarë është 2,711,518 (dy milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

TABELA PËRMBLEDHËSE E SHPRONËSIMEVE PËR OBJEKTIN “TREGU INDUSTRIAL USHQIMOR-MARKATA”, BERAT

Nr	Gjeneralitetet e pronarit	Ferdi Hajdar Dura	Hajrulla Shyqyri Dura	Benjamin Shyqyri Dura	Nuredin Fejzi Seitaj	Ylli Shaban Reka
1	Zona Kadastrale respektive	8502	8502	8502	8502	8502
2	Nr. I prones	8/139N1	8/139N2	8/139N3	8/139N4	8/155
3	Siperfaqe e truallit ne pronesi	5	5	12	10	
4	Siperfaqe ndertimore te objektit qe do te shpronesohet(faktike)	8.8	11.3	15.4	11.1	90
5	Siperfaqe ndertimore te objektit qe do te shpronesohet(sipas dokumentave te pronesise)	5	5	12	10	90
6	Cmimin per njesi te truallit sipas VKM nr.89 date 3.02.2016	4183	4183	4183	4183	
7	Vleren e truallit ne total qe do te shpronesohet	20915	20915	50196	41830	
8	Vlera e perlllogaritur e ndertesese sipas faktit(Vlera e preventivuar)	236,471	251,973	263,581	298,189	1,857,786
9	Vlera e perlllogaritur (interpoluar) e ndertesese sipas siperfaqeve te dokumentave te pronesise	134,358	111,492	205,387	268,639	1,857,786
10	Vlera totale per shpronesim(Truall+ ndertese sipas dokumentave te pronesise)	155,273	132,407	255,583	310,469	1,857,786
	Shuma gjithsej				Leke	2,711,518

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë